



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS  
KOSOVA HANDBALL FEDERATION  
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

# MBI PUNËN E KOMISIONIT PËR MIRËNJOHJE, SHPËRBLIME DHE DEKORATA DHE KRITERET PËR ZGJEDHJENË E SPORTISTËVE MË TË MIRË TË VITIT

Në bazë të nenit 6 dhe 10.10 të Statutit të FHK-së, Bordi i FHK-së në mbledhjen e vetë të mbajtur më 01.10.2022, miratoj këtë:

## **RREGULLORE**

### **MBI PUNËN E KOMISIONIT PËR MIRËNJOHJE, SHPËRBLIME DHE DEKORATA DHE KRITERET PËR ZGJEDHJENË E SPORTISTËVE MË TË MIRË TË VITIT**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore, rregullohen statusi dhe procedura për Komisionin për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata, për sportistët ekipet, shoqatat, punëtorët sportiv, gazetarët sportiv dhe individ tjerë si dhe kriteret për zgjedhjen e sportistëve më të mirë të vitit. Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata i Federatës së Hendbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm 'Komisioni').

Selia e Këshillit të garave është në Prishtinë, në selinë e Federatës së Hendbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme FHK).

#### **Neni 2**

Komisionin e zgjedh dhe e shkarkon Bordi i FHK-së. Mandati i Komisionit për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata garave zgjatë 2 vite me mundësi rizgjedhje edhe një mandat.

#### **Neni 3**

Komisioni përbëhet prej tre (3) anëtarëve, Kryetarit dhe dy anëtarëve.

Kryetari i Komisionit udhëheq me punën e Komisionit për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata.

Në mbledhjet e Komisionit për mirënjohje dhe dekorata të FHK-së mund të merr pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i FHK-së, mirëpo, vetëm në cilësinë këshill-dhënëse dhe pa të drejtë vote ose vendim marrjeje.

#### **Neni 4**

Duke pasur parasysh angazhimin, punën, sukseset si dhe prezantimin e sportit Kosovar në vend dhe jashtë vendit, Federata e Hendbollit të Kosovës parasheh këto mirënjohje dhe dekorata, për sportistët ekipet, shoqatat, punëtorët sportiv, gazetarët sportiv dhe individ tjerë si vijon:

- Mirënjohje
- Falënderime
- Diploma për ekipe
- Diploma për individ
- Plaket (e artë, argjendtë dhe e bronzit) Medalje (e artë, argjendtë dhe e bronzit)
- Shenja të FHK-së (e artë, argjendtë dhe e bronzit)
- Flamuj përkujtimor

- Kupa
- Dhurata dhe rekuizita sportive
- Dhurata speciale për masivizim, cilësi dhe fer- plej
- Dhuratë speciale, përcjellja e ndonjë manifestimi apo ngjarje me rëndësi sportive në Kosovë apo jashtë sajë
- Dhuratë me të holla të gatshme

### **Neni 5**

Ndarja e mirënjohjeve, dekoratave dhe shpërblimeve bëhet në bazë të rezultateve të arritura në garat ndërkombëtare dhe deri tek rangu më i ulët i garave në garat vendore (lojërat olimpike, kampionatet botërore, evropiane, mediterane, ballkanike, kombëtare, komunale dhe shkollore).

### **Neni 6**

Vlerësimi i rezultateve të arritura të ekipeve, individëve dhe të tjerëve bëhet sipas këtyre mënyrave:

- a. kriterëve të përcaktuara në tabelën e cila është pjesë përbërëse e kësaj
- b. Rregulloreje
- c. në bazë të nominimeve nga të anketuarit (trajnerëve, klubeve etj.) të cilën e kërkon
- d. Komisioni
- e. sipas vendimit të Komisionit për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata. Kriteret dhe elementet për disa kategori janë të përshkruara dhe janë bashkangjitur tabelës dhe kësaj Rregullore, kurse në rastet specifike Komisioni do të vlerëson kontributin e secilit.

### **Neni 7**

Kriteret dhe elementet për disa kategori të tjera, si zgjedhja e punëtorit më të mirë sportive, gjyqtarit më të mirë, trajnerit, gazetarit më produktiv etj. janë të përcaktuar në tekstin i cili i bashkëngjitet tabelës. Për këto kategori vlejné këto elemente:

- a. masivizimit, cilësia, organizimi, numri i ekipeve, numri i garave të organizuara, pjesëmarrja në gara në vend dhe jashtë sajë, rezultatet etj.
- b. tek individët, si gjyqtari, punëtori sportive etj. për bazë merren realizimi sistematik i detyrave të parashtruara, nga numri i aktiviteteve të realizuara, dhe duke ju falënderuar punës së tyre në organizimin cilësor të detyrave të tyre, dhe një bashkëpunimi korrekt mes lojtarëve dhe bashkëpunëtorëve, kanë ndikuar në përparimin dhe avancimin e sportit të Kosovës, si në rrafshin e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtar.

### **Neni 8**

Për garat e rangut komunal dhe atij rajonal, FHK-ja mund të ndajë:

- a. medalje

- b. diploma
- c. dhe dhurata modeste ekipeve dhe individëve për plasman në vendet: I, II, III.

#### **Neni 9**

Për garat dhe e organizuara në nivel kombëtare (shtetërore) dhe aktivitete tjera të këtij rangui, FHK-ja mund të ndajë: a) plaket të arta

- a. plaket të argjendtë
- b. plaket të bronzit
- c. kupa ekipit për plasman në vendin I
- d. diploma ekipeve për plasman për vendin I, II, III
- e. medalje ekipeve për plasman për vendin e I, II, III,

#### **Neni 10**

Për asociacionet e veta si Shoqatat e gjyqtarëve dhe trajnerëve, klubet, Shkollat e Hendbollit etj. FHK-ja ndanë:

- a. mirënjohje
- b. shpërblime të posaçme

#### **Neni 11**

Në raste specifike Komisioni për mirënjohje mund t'u ndajë shpërblime të gjithë pjesëmarrësve, në ndonjë manifestim me karakter kombëtar (shtetëror) festiv, me ndarje të:

- a. diplomave
- b. shenjave të FHK-së
- c. suvenirëve të ndryshme si kujtim për ato ngjarje

#### **Neni 12**

Federata e Hendbollit e Kosovës i propozon Shoqatës së trajnerëve dhe asaj të gjyqtarëve, klubeve, Shkollave të hendbollit etj. që sipas mundësisë të ndajnë mirënjohje ose shpërblime në fushën e veprimtarisë dhe aktivitetit të tyre.

#### **Neni 13**

Më qëllim të stimulimit të organizatorit të garave, punës që e bëjnë, duke pasur parasysh rangun e garave apo të turneve, dhe aktivitetit të tyre të cilët pa rezervë angazhohen në realizimin për përparim dhe avancim të hendbollit, Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata mund të ju ndajë: a) diploma

- a. plaket speciale
- b. shpërblime tjera

## Neni 14

Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata, në fund të çdo viti, për shpalljen e më të mirëve në bazë të kriterëve të përcaktuar me këtë Rregullore, bënë propozimin e

listës dhe të njëjtën ja paraqet Bordit të FHK-së në miratim.

## Neni 15

Bordi i FHK-së bënë shpalljen e më të mirëve të vitit si:

- sportistin (hendbollistin) e vitit (meshkujt),
- sportistën (hendbollistën) e vitit (femrat)
- a. 7 hendbollistët e vitit në konkurrencën Superligës së meshkujve sipas pozitive që luajnë në skuadër duke filluar nga portieri, alo e majtë, fundori i majtë, lojtari i qendrës, lojtari i vijës, fundori i djathtë dhe alo e djathtë.
- b. 7 hendbollistet e vitit në konkurrencën e Superligës së femrave sipas pozitive që luajnë në skuadër duke filluar nga portieri, alo e majtë, fundorja e majtë, lojtarja e qendrës, lojtarja e vijës, fundorja e djathtë dhe alo e djathtë.
- c. Hendbollistin më efikas në vitin kalendarik (jo ne dicionin e garave) në konkurrencën e Superligës së meshkujve
- d. Hendbollisten më efikase në vitin kalendarik në konkurrencën e Superligës së femrave
- e. Hendbollisti më i dalluar në fazën e mbrojtjes
- f. Hendbollistën më të dalluar në fazën e mbrojtjes
- g. 5 hendbollistët më të mirë në konkurrencën e juniorëve
- h. 5 hendbollistët më të mira në konkurrencën e kadetëve
- i. 5 hendbollistet më të mira në konkurrencën e kadeteve

## Neni 16

Bordi i FHK-së bënë shpalljen e më të mirëve të vitit si:

- a. trajneri më i suksesshëm sipas propozimit të SHTHK-së në konkurrencën e meshkujve dhe femrave, propozimin e shqyrton Komisioni dhe miraton Bordi i FHK-së.
- b. qifti i gjyqtarëve më të suksesshëm sipas propozimit të SHGJHK-së, propozimin e shqyrton Komisioni dhe miraton Bordi i FHK-së.

## Neni 17

Bordi i FHK-së bënë shpalljen e më të mirëve të vitit si:

- a) klubi më i mire në konkurrencën e meshkujve
- b) klubi më i mire në konkurrencën e femrave

Bordi me mirënjohje nderon edhe klubet e grupmoshave:

- a) klubi më i mire në konkurrencën e juniorëve
- b) klubi më i mire në konkurrencën e kadetëve dhe kadeteve
- c) klubi më i mire në konkurrencën e pionierëve dhe pioniereve

## **Neni 18**

Bordi i FHK-së bënë shpalljen e më të mirëve të vitit si: a) gazetari apo mediumi më i frytshëm gjatë vitit

- a. punëtori më i dalluar sportiv

## **Neni 19**

FHK-ja mund ti ndaj mirënjohje dhe falënderime edhe asociacioneve jo sportive, të cilat kanë kontribuar dhe kontribuojnë në zhvillimin e sportit dhe organizimin e garave të hendbollit, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.

## **Neni 20**

Kriteret e përcaktuar në këtë Rregullore, janë obliguese për të gjitha asociacionet e FHKsë.

## **KRITERET PËR VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË LËMINË E HENDBOLLIT PËR SHPALLJEN E MË TË MIRËVE**

## **Neni 21**

Për listën e më të mirëve mund të nominohen:

1. Sportist (hendbollist) nga klubet të cilat janë anëtare të Federatës së Hendbollit të Kosovës, dhe të cilët kanë zhvilluar aktivitet gjatë vitit kalendarik në Kosovë.
2. Individët të inkuadruar në hendboll si punëtor profesional:
  - a. Trajner në konkurrencën e meshkujve dhe femrave
  - b. gjyqtar
  - c. punëtor sportive ...
  - d. Klubet
  - e. Shkollat e hendbollit
  - f. Organizatat dhe institucionet tjera të cilat në një apo tjetër mënyrë kanë ndikuar në zhvillimin e hendbollit.

## **Neni 22**

Propozimet për pozicionet 1,2,3,4,5 duhet të bëhen ekskluzivisht përmes Komisionit për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata në bazë të rezultateve faktike.

Kurse Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata për pozicionet tek neni 15 vendos për formën e përzgjedhjes më të mirëve si vijon:

- a. në bazë të propozimit (nominimit) të trajnerëve të skuadrave elite (Superligave në të dy konkurrencat), dhe

- b. rezultateve faktike sipas garave të zhvilluara gjatë vitit kalendarik të paraqitur edhe në formën sipas tabelës tek neni 28 i kësaj Rregulloreje.

### Neni 23

Kusht, për shpalljen e sportistit dhe sportistëve më të mire të vitit paraqesin:

1. Rezultatet e arritura në gara:

- gara ndërkombëtare
- gara kombëtare (shtetërore)

### Neni 24

Pranë kritereve standarde, për vlerësimin e cilësisë dhe përcaktimin për klubin, Shkollën e hendbollit... duhet të merren parasysh edhe këto komponentë me parametra specifike:

- Niveli i garave
- Sistemi i garave
- Konkurrenca – masiviteti i garave

### Neni 25

Trajner më të suksesshëm Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata, shpall atë trajner i cili gjatë një viti kalendarik, ka pasur më së shumti suksese në bazë të rezultateve, si dhe në atë me punën me gjeneratat e reja dhe inkuadrimin e tyre në skuadrat e para. Pastaj niveli i garave, masiviteti etj.

Trajner më të suksesshëm në konkurrencën e meshkujve dhe femrave Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata, shpall atë trajner të cilin paraprakisht e shpall Shoqata e Trajnerëve të Hendbollit të Kosovës dhe ne garë janë të gjithë trajnerët e licencuar dhe janë anëtarë të SHTHK-së të cilët punojnë me klube dhe përfaqësuese.

Trajnerët e Kombëtareve të Kosovës të cilët arrijnë rezultate në arenën ndërkombëtare SHTHK-ë gjegjësisht të Komisionit të FHK mund të nominohen për mirënjohje, plaket etj. sipas nenit 4 të Rregullores.

### Neni 26

Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata për shpalljen e sportistëve më të mire të vitit, në lëmin e ndarjes së drejtësisë e shpall qiftin e gjyqtarëve më të suksesshëm të FHK-së, në bazë të propozimit të SHGJHK-së, e cila duhet të bëjë këtë në bazë të kritereve të notimit të ndeshjeve të drejtuara nga ky qift si vijon:

|                                                                                           |              |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| - Vlerësimi në Kampionatin e Kosovës nga Vëzhguesi dhe Komisari për vlerësimin e gjykimin | 5 - 10 pikë  |
| - Testimet teorike dhe fizike, dënimet dhe dorëheqjet                                     | 0,5 - 2 pikë |
| - Vlerësimi në Garat e Kupave të EHF-it (Kupat dhe ndeshjet kualifikuese të kombëtareve)  | 5 – 10 pikë  |

|                                                                                      |        |
|--------------------------------------------------------------------------------------|--------|
| Pjesëmarrja në pjesën finale të Kampionateve Evropiane dhe Botërore sipas kategorive | 1 pikë |
| Kampionati për kadet apo juniorë WORLD apo EURO                                      | 2 pikë |
| Kampionati seniorë evropian                                                          | 3 pikë |
| Kampionati botëror seniorë                                                           |        |

Vlerën e pikëve në garat e Kampionatit të Kosovës e përcakton Këshilli drejtues – SHGJHK-së sipas notimit nga kontrolluesit dhe Komisioni për vlerësimin e gjyqimit, kurse të garave të Kupave të EHF-it Raporti i zyrtarëve përgjegjës të EHF-it që publikohet në faqen zyrtare të EHF-it.

Si gjyqtar më të suksesshëm shpallën ekskluzivisht vetëm qifti i gjyqtarëve, e jo gjyqtarët si individ.

Gjyqtarët e FHK-së të cilët arrijnë rezultate në arenën ndërkombëtare me propozim të SHGJHK-së gjegjësisht të Komisionit të FHK mund të nominohen për mirënjohje, plaketa etj. sipas nenit 4 të Rregullores.

### Neni 27

Punëtor sportiv, Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata shpall atë individ i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen, zhvillimin dhe masivitetin e lojës së hendbollit, brenda një viti, çka është vështirë të përcaktohet Komisioni vetëm për një vit kalendarik, por Komisioni mund të marrë në shqyrtim një periudhë më të gjatë kohore.

### Neni 28

Shpallja e sportistëve më të mirë, trajnerëve dhe klubeve bëhet në bazë të tabelës e cila disponon me të gjitha kriteret, në formë tabelare, ku janë të përfshira të gjitha aktivitetet e mundshme të sportistëve tanë gjatë një viti si vijon:

| NIVELI I GARAVE      | SKUADRA |    |    |       | TRAJNERI |    |    |       | LOJT |    | ARI |       |
|----------------------|---------|----|----|-------|----------|----|----|-------|------|----|-----|-------|
|                      | 1       | 2  | 3  | Pjes. | 1        | 2  | 3  | Pjes. | 1    | 2  | 3   | Pjes. |
| Lojërat Olimpike     | 100     | 95 | 90 | 85    | 100      | 95 | 90 | 85    | 100  | 95 | 90  | 85    |
| Kampionatet botërore | 95      | 90 | 85 | 80    | 95       | 90 | 85 | 80    | 95   | 90 | 85  | 80    |
| Kampionate evropiane | 90      | 85 | 80 | 75    | 90       | 85 | 80 | 75    | 90   | 85 | 80  | 75    |
| Kampionati mediteran | 80      | 75 | 70 | 65    | 80       | 75 | 70 | 65    | 80   | 75 | 70  | 65    |
| KUPA e EHF-it        | 75      | 70 | 65 | 60    | 75       | 70 | 65 | 60    | 75   | 70 | 65  | 60    |
| Kampionati i Kosoves | 70      | 65 | 60 | 55    | 70       | 65 | 60 | 55    | 70   | 65 | 60  | 55    |
| Kupa e Kosovës       | 65      | 60 | 55 | 50    | 65       | 60 | 55 | 50    | 65   | 60 | 55  | 50    |
| Turne të ndryshme    | 60      | 55 | 50 | 45    | 60       | 55 | 50 | 45    | 60   | 55 | 50  | 45    |
| Liga e juniorëve     | 55      | 50 | 45 | 40    | 55       | 50 | 45 | 40    | 55   | 50 | 45  | 40    |
| Liga e kadetëve      | 45      | 40 | 35 | 30    | 45       | 40 | 35 | 30    | 45   | 40 | 35  | 30    |
| Liga e pionierëve    | 40      | 35 | 30 | 25    | 40       | 35 | 30 | 25    | 40   | 35 | 30  | 25    |

### Neni 29

Këtë Rregullore e aprovon Bordi i FHK-së, kurse ndërrimet dhe plotësimet i propozon Komisioni për mirënjohje, shpërblime dhe dekorata të cilat i miraton Bordi i FHK-së.

### Neni 30

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i FHK-së.

  
**Bordi i FHK-së**  
**Eugen Saraçini**  
**President**

